

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E DEQANIT - ZYRA E PROKURIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **631-20-4405-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **PROGRAMI PËR ENERGJI EFIQIENTE NË KOMUNËN E DEQANIT**

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK

" **TONI INGJINJERING**"SH.P.K -Nr. 810199861 (Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

NEGROC - GLLOGOC

(Adresa)

GLLOGOC 13000

(Vendi)(Kodi postar)

044 249 730

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

MALUSH KRASNIQI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

toni.ingjinjering@hotmail.com (Adresa elektronike)

22/08/2020

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtoj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Njoftim për kontratë (B05) me datë 19/08/2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

Na është dërguar B12 Procesverbali i Hapjes, nuk kemi

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet



A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e më tutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?
PO ☐ Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Kërkesa jonë për Ri-shqyrtim ka të bëjë me Ri-shikimin në përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të pjesëmarrjes së njoftimin dhe dosjen e tenderit të këtij aktiviteti të prokurimit.

PRANDAJ JU KENI SHKELË LIGJIN E PROKURIMIT PUBLIK NË NENET E MË POSHTME SI NJOFTIMET E KRPP-së TË DATAVE 22/11/2019 DHE 21/04/2020:

1. NENI 1 PIKA 1 - QËLLIMI I LIGJIT
2. NENI 7 PIKA 1 - BARAZIA DHE TRAJTIMI
3. NENI 51 PIKA 3 - PËRCAKTIMI I KRITEREVE

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Faktet dhe Argumente tona janë:

1. Nuk është respektuar Neni 1 pika 1 e LPP-së (Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike).
2. Nuk është respektuar Neni 7 pika 1 i LPP-së (Barazia dhe Trajtimi, Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente).
3. Nuk është respektuar Neni 51 pika 3 i LPP-së, citojmë: "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse".
4. Nuk janë respektuar Njoftimet e KRPP-së të datave 22 nëntor 2019 rreth mos kërkesave të ISO pa pasë nevojë, pa qenë në harmoni me natyrën e projektit dhe të datës 21 prill 2020 rreth mos kërkesave për noterizim të dokumenteve kur nuk është e nevojshme dhe për të cilat lehtë mund të verifikohen.



Argumentet tona:

- a) Në Njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit Neni 7.1 & 7.2, Kërkesa 4: Keni kërkuar certifikaten e origines se produktit është me origjin te EU ,qe kjo kerkesë deri ne ket pikë mirë është mirpo shifrat e cekura 60598-2-3 2013 dhe IEC 62722-2-1 favorizon vetem ni prodhues dhe ni OE.
- b) Evidenca 5.-Ne paramasen e tenderit keni percaktu tipin e trupav ndriques me fuqi dhe sa Lumen dritë japin per një wat, prandaj fotometria e ndriqimit është e kryer sepse jan percaktu trupat ndriques per ket projekt,Ndersa auditor i Energjisë ose trajner per auditor te energjisë ne ndriqimin publik i qertifikuer me standardin EN 16247.Kta auditor qe i keni cek kta kan te bajn me projekte dhe laboratore ku percaktohen vetit,cilsit dhe parametrat tjer te paisjeve siq jan trupat ndriques,materialet termo izoluese etj.Prandaj kjo kerkesë është diskriminuese per OE,sepse projekti i shpallur nga ju nuk ashtë hapje e ndoni laboratorit testues apo projektues per punë d.m.th.vendosja e ndriqimit publik me llampa efiqente -LLED LLAMP,qe kto jan te definuara ne paramas se qfare dote vendosen.
- c) Kërkesa nr. 6.Autorizimi nga prodhuesit duhet te jet origjinal apo i notarizuar-Si ka mundsi qe ket autorizim ta kemi origjinal apo i notarizuar,ku prodhuesi është nga Austria,Anglia apo Kina mbrenda ni afati shum te shkurter edhe populli i Kosoves 95% ka mundsi dhe dokumentacion vetem ne Shqipri me shku Pse ka nevojë certifikata e prodhuesit të noterizohet, kur ajo dërgohet nëpërmes internetit dhe e ka kodin e vete i cili edhe mund të verifikohet poashtu nëpërmes ineternetit. edhe per moster te trupit ndrques perse me sjellë, lind pytja qfar mekanizma apo kapacitete kan komunat tona e shum tjera qe ti vertetoin karakteristikat e kti trupi ndriques qe sillet si moster e ktu bash ka mundsi te sillet ni LLED prej ma te doptit Prandaj si e tillë e është e panevojshme dhe favorizuese për një grup të OE, Ne
- d) Në Njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit Neni 9.1 & 9.2, Dëshmia 7 dhe 8: Keni kërkuar, citojmë:Per menagjerin e projektit te ket qertifikat te Auditorit me standardin EN 16247 dhe e notarizuar. Ne Kosovë mund te jen 4 deri 6 ksi te cilet jan te punsuar ne institucione te shtetit qe jan qertifiku permes donacioneve ne vendet tjera europjane apo atyre botrore ne form seminareve.Ndersa ingjinjeret ne kompani kan ba menagjimin e te gjitha projekteve qe kompania i ka realizu dmth kan provoj dhe njohuri se një Auditor i qertifikun me tri ditë seminar.-Kontrata e shpallur i perket punime te ni projekti te ndriqimit publik,e jo **auditimit** te punimeve tjera apo punve qe ne i kryejm. Auditimin duhet ta bej AK. Gjat punimeve dhe ne perfundim te punimeve qe asht pranimi teknik.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.



Dëmet pos atyre morale jemi të demtuar edhe në aspektin për konkurim, dëmit ekonomik dhe financiar i fitimit të planifikuar shumë të shumës së projektit , Humbja e imazhit etj.etj.

Kërkojmë që të gjitha kto që u ceken në pikat a,b,c,d. të hiqet komfor Njoftimit të KRPP-së të datë 22/11/2019.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Të bashkangjitura, janë:

1. Njoftimi për kontratë 19 gusht 2020
2. Njoftimi i KRPP-së i datës 22 nëntor 2019 dhe
3. Njoftimi i KRPP-së i datës 21 prill 2020

10. Propozim:

Propozojmë Zyrës së Prokurimit që së pari të pezullohet aktiviteti i prokurimit, të nxirret Vendim i arsyeshëm dhe me B54 Njoftimin për Informata shtesë apo përmirësim gabimi të **hiqen sipas argumentit ton në pikat a,b,c,d** apo edhe për dokumente tjera.Ju lutemi veproni komfor Njoftimeve të KRPP-së të datave **22.11.2019 & 21.04.2020** sepse kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga ana e Juaj janë në mënyrë joprofesionale mosrespektim i ligjeve në fuqi duke përfshirë LPP-në dhe ligjet tjera që e rregullojnë këtë lëmi, shkurt kriteret e përcaktuara janë të tepërta për disa OE dhe favorizuese për disa të tjera.

Presim Ri-Shqyrtimin e kriterëve dhe kushteve për pjesëmarrje.

